



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 13.1 shkronja a të Ligjit për tokën bujqësore nr. 02/L-26, nenit 6.3 Udhëzimin Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr. 41/2006 i datës 27.12.2006 dhe nenit 19 shkronja c të Statutit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 10 prill 2014, miratoi këtë

VENDIM

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË PËRHERSHËM TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE

Neni 1

Miratohet kërkesa e Smajl Shahin Isufit nga fshati Majac, komuna e Podujevës, për ndërrimin e përhershëm të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të paluajtshmërisë së evidentuar sipas ngastrës kadastrale nr. 618-0 kultura – arë Kl, 3 vendi i quajtur Ara nën rrugë në sipërfaqe prej 0.05,65 ha. (565 m²), Zona kadastrale Majac, Certifikata nr. 08/04/095/6652/2014.

Neni 2

Pronari obligohet që paluajtshmërinë përkatëse ta shfrytëzoj për ndërtimin e objektit të stallës për bagëti.

Neni 3

Regjistrimin, në librat kadastral, të pronës përkatëse për ndërrim të destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në emër të pronarit e bënë Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 4

Vendimi bëhet përfundimtar pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 8.6 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr. 41/2006, përkatësisht pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 5

Vendimin e zbatojnë Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrotjtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 6

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-320-32372
Podujevë,
10 prill 2014



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi